

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri;

Duke njohur bashkëpunimin e këtij Instituti me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera vendase e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Institutit;

Duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij Instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të ruajtjes së kujtesës sonë kolektive;

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2025 në këto drejtime:

Rritjen e prodhimit shkencor dhe botues të institucionit, me përgatitjen për botim të një kolane prej 11 titujsh, përfshirë monografi, përmbledhje dokumentesh arkivore, libra memuaristik, albume dhe numra të revistës shkencore “Memoria”.

Zgjerimin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes pjesëmarrjes në rrjete dhe platforma evropiane të kujtesës historike, nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione homologe, si dhe zhvillimit të projekteve të përbashkëta kërkimore.

Zgjerimin e veprimtarisë edukative dhe përfshirjen në sistemin arsimor përmes leksioneve të hapura në shkolla dhe universitete, bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit, si dhe realizimit të aktiviteteve në institucionet arsimore në nivel kombëtar.

Pasurimin e arkivit institucional dhe forcimin e dokumentimit historik përmes shtimit të materialeve arkivore, intervistave me ish-të përndjekur politikë dhe zgjerimit të fondit audioviziv të Institutit.

Zhvillimin e projekteve kërkimore afatgjata të fokusuara në studimin e institucioneve represive, mekanizmave të kontrollit shtetëror, politikave ekonomike dhe propagandës së regjimit komunist.

Kuvendi rekomandon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2026 të angazhohet veçanërisht në këto drejtime:

1. Të finalizojë hartimin e udhëzuesit praktik për mësuesit për periudhën e komunizmit dhe të sigurojë pilotimin e tij në sistemin arsimor në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të arsimit përpara integrimin të plotë në procesin mësimor.

2. Të priorizohen studimet afatgjata për strukturat represive, kufirin, propagandën dhe institucionet e diktaturës, duke vendosur afate të qarta dhe rezultate të matshme për publikime shkencore.

3. Të zgjerojë më tej veprimtarinë edukative në të gjitha nivelet e arsimit përmes institucionalizimit të leksioneve të hapura në universitete, bashkëpunimeve me departamentet e historisë dhe zgjerimit të programit në shkollat parauniversitare.

4. Të thellojë bashkëpunimin ndërkombëtar me institucione homologe, duke e orientuar atë drejt projekteve të përbashkëta kërkimore, botimeve dhe aktiviteteve akademike në kuadër të rrjeteve evropiane të kujtesës historike.

5. Të nxisë dhe të kontribuojë në një diskutim në nivel kombëtar për mënyrat e trajtimit të trashëgimisë materiale të komunizmit, me synimin për ta kthyer këtë trashëgimi në një instrument informimi dhe edukimi për brezat e rinj.

6. Të intensifikojë angazhimin për pasurimin e koleksioneve të muzeve të ndryshëm në vend me botimet e Institutit, me qëllim rritjen e aksesit publik ndaj dokumentimit historik dhe forcimin e rolit edukativ të institucioneve muzeore.

7. Të intensifikojë bashkëpunimin me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe institucionet arsimore në funksion të edukimit dhe ndërgjegjësimit qytetar dhe zhvillimit të programeve dhe aktiviteteve edukative për ruajtjen dhe promovimin e kujtesës historike për periudhën e regjimit komunist.

8. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda tremujorit të tretë të këtij viti.

Miratuar në datën 30.6.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi